**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË**
**DREJTORIA E PËRGJITHSHME E METROLOGJISË**
**DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE**

**Nr. 66 Prot.** **Tiranë më 11.01.2023**

***Lënda:*** *Dërgohet për miratim plani i punës për Drejtorinë e Përgjithshme të Metrologjisë, për vitin 2023.*

**Znj. Delina IBRAHIMAJ**
**MINISTËR I FINANCAVE DHE EKONOMISË**

**TIRANË**

**E Nderuar Znj. Ministre,**

Në mbështetje të Rregullores së Brendshme Nr. 104/1, datë 07.02.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e DPM-së", Ju përcjellim për miratim Planin e Punës të Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë, për vitin 2023.

Bashkëlidhur formati i planit për vitin 2023.

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin,

**DREJTORI I PËRGJITHSHËM**

**Petrit Rama**

Adresa: Autostrada Tiranë-Durrës, km 8, Kashar, Tiranë, web: www.dpm.gov.al, e-mail: metrology@dpm.gov.al

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË**
**DREJTORIA E PËRGJITHSHME E METROLOGJISË**
**DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE**

**MIRATOHET**

**MINISTËR I FINANCAVE DHE EKONOMISË**

**Delina IBRAHIMAJ**

# PLANI I PUNËS I DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË METROLOGJISË PËR VITIN 2023

Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë ushtron veprimtarinë në mbështetje të Ligjit Nr. 126, datë 15.10.2020 "Për Metrologjinë".
Ky ligj rregullon sistemin kombëtar të Metrologjisë në Shqipëri dhe kërkesat për të kryer veprimtaritë në metrologjinë shkencore, industriale dhe atë ligjore.
Dispozitat e këtij ligji do të zbatohen në ato instrumente matëse, që përdoren për matje në transanksionet tregtare dhe zyrtare, kujdesin shëndetësor, mbrojtjen e mjedisit, rendin publik, sigurinë dhe mbrojtjen e konsumatorit.
Sistemi kombëtar i Metrologjisë përbëhet nga:
a) Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë;
b) Laboratorët e autorizuar si mbajtës të etaloneve kombëtare dhe sekondare;
c) Personat juridikë privatë të autorizuar me një nga format e parashikuara në legjislacionin në fuqi për të kryer shërbimet e parashikuara në këtë ligj;
ç) Personat juridikë të autorizuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë për të kryer verifikim periodik të instrumenteve në metrologjinë ligjore, sipas dispozitave të këtij ligji;
d) Personat juridikë dhe fizikë të autorizuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë për të kryer riparim të instrumenteve matëse.

Misioni ynë është:
- Mbrojtja e konsumatorëve dhe shtetit nga rezultatet e pasakta të matjeve;
- Zhvillimi i sistemit kombëtar të metrologjisë në përputhje me kerkesat ndërkombëtare dhe nevojat kombëtare;
- Njohja ndërkombëtare e rezultateve të matjeve kombëtare dhe te etaloneve kombëtare të matjeve;
- Lëvizjen e lirë të instrumentave matëse ligjerisht të kontrolluara, nëse keto instrumenta kanë shenjën e miratimit të tipit dhe verifikimit fillestar;
- Lëvizjen e lirë të produkteve të parapaketuara, nëse ato kanë shenjën e konformitetit dhe harmonizimin e metodave për matjet dhe kontrollin metrologjik.

Organizimi i Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë:

1. Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë është person juridik, publik, i specializuar për metrologjinë, me qendër në Tiranë dhe e organizuar në Sektore Sherbimi ne rrethe, në varësi të ministrit përgjegjës për Financat dhe Ekonominë.

2. Juridiksioni i ushtrimit të veprimtarisë së Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë është i gjithë territori i Republikës së Shqipërisë, ndërsa për Sektoret e Sherbimit, territori përcaktohet nga ministri përgjegjës për Financat dhe Ekonominë, me propozimin e Drejtorisë së Përgjithshme e Metrologjisë.

3. Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë drejtohet nga Drejtori i Përgjithshëm, i cili është nëpunës civil. Rekrutimi i nëpunësve të Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë bëhet sipas kushteve dhe kritereve të përcaktuara në Ligj. Nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil". Struktura organike e DPM-së është 103 vetë nga të cilët 96 janë pozicione me status nëpunës civilë dhe 8 janë punonjës mbështetës me kontratë pune.

4. Organizimi dhe funksionimi i Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë rregullohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

5. Drejtoria e Pergjithshme e Metrologjise ka kater drejtori, përkatësisht:

- Drejtoria e Metrologjisë Shkencore dhe Industriale (DMSHI)
- Drejtoria e Metrologjisë Ligjore (DML)
- Drejtoria e Sigurimit të Cilësisë dhe Parapaketimeve (DSCP)
- Drejtoria e Burimeve Njerezore dhe Shërbimeve (DBNJSH)

DPM është antare me të drejta të plota në organizatat ndërkombetare EURAMET, BIPM, WELMEC, OIML, IMECO.

Shërbimet kryesore metrologjike janë:

-Shërbime të kalibrimit që ofrohen nga laboratoret e Drejtorisëte Metrologjisë Shkencore dhe Industriale sipas kërkesave të subjekteve apo institucioneve shteterore që përdorin instrumente matësnë fushat e masës, gjatësise, forcës, presion, elekrikut, termometrisë, lagështirës, volumeve dhe kimisë.

-Shërbime metrologjike të verifikimit të instrumenteve matës ligjërisht të kontrolluar të ofruara nga Drejtoria e Metrologjisë Ligjore si peshoret automobilistike, peshoret e tregtimit më pakicë nga subjektet tregtare dhe ato farmaceutike, masat volumore, metrat e llojeve të ndryshme, depozitat dhe taksimetrat.

-Shërbime të autorizimit/monitorimit të subjekteve të autorizuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë që kryejnë verifikimin e instrumenteve matës që nuk kryhen nga Drejtoria e Metrologjisë Ligjore por autorizojne subjekte të treta, ku hyjne shërbimi i verifikimit të matesave të ujit, matësave elektrik, autoboteve, shërbime të riparimit të instrumenteve matës që përdorin subjektet e ndryshme.

Për të gjitha këto shërbime DPM zbaton tarifa të miratuara me udhëzim përkatës.

Cdo vit planifikohen trajnime të specialistëve, me programe specifike brënda vendit. Gjithashtu specialistët tanë marin pjesë në komitete të ndryshme teknike që organizohen në vende të ndryshme sipas grafikut të EURAMET.

Për të patur një gjumueshmeri sa më të lartë, pajisjet që përdoren nga laboratoret e DMSHI kalibrohen jashtë shtetit ne Institute Metrologjike sipas procedures se prokurimit të realizuar nga DPM.

Në drejtim të sistemit të menaxhimit të cilësisë është bërë mirëmbajtja dhe zgjerimi i sistemit të menaxhimit të cilësisë në DMSHI dhe DPM në përputhje me SSH EN ISO/IEC 17025:2017:

-Draftimi, rishikimi dhe miratimi i procedurave të kalibrimit/instruksioneve të punës për laboratoret elektrik, temperaturës, gjatësisë, kimisë, lagështirës, elektrikut, forcë, masë, presion, volume në përputhje me dokumentacionin e Sistemit të Menaxhimit të Cilesisë së DPM-së.

-Përgatitja për aplikim për akreditim të laboratoreve të matjeve elektrike, temperaturës, analizuesve të frymës, forcës, mases, gjatesise dhe lageshtires nga një trupe firmetare e EA-MLA për kalibrim.

Faktori kryesor që mund të rrezikojë mos realizimin e këtij plani është mos kalibrimi i paisjeve të laboratoreve pasi do të pengonte ofrimin e shërbimit të kalibrimit nga ana e laboratoreve të DMSHI-së, marrjen pjesë në teste zotësie që janë të nevojshëm për të aplikuar për procesin e akreditimit të laboratoreve. Gjithashtu do të pengonte procesin e kalibrimit nga DMSHI të mjeteve matëse që përdorin specialistet e DML.

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË**
**DREJTORIA E PËRGJITHSHME E METROLOGJISË**

# PLANI I PUNËS I DREJTORISË TË PËRGJITHSHME TË METROLOGJISË PËR VITIN 2023

MIRATOHET

MINISTËR I FINANCAVE DHE EKONOMISË

Delina IBRAHIMAJ

**DREJTORIA E METROLOGJISË SHKENCORE DHE INDUSTRIALE**

| NR | OBJEKTIVAT/MASAT DHE VEPRIMET E MARRA | TREGUESIT MONITORUES/STATUSI I REALIZIMIT | STRUKTURA PËRGJEGJËSE | AFATI |
|---|---|---|---|---|
| **Objektivi nr.1: Kalibrimi i etaloneve kombetare te njesive te matjes** | | | | |
| 1. | Organizimi dhe realizimi i prokurimit për kalibrimin e pajisjeve standarde reference të DPM në institute homologe jashtë vendit, apo subjekte të akredituara për kalibrim. | Përcaktimi sipas prioriteteve të specifikimeve teknike dhe fondit limit. | Çdo sektor/specialist i DMSHI | 6 mujori i parë |
| **Objektivi nr.2: Pjesëmarrje në ndërkrahasime dhe pjesemarrja në testimin e aftësive matëse.** | | | | |
| 2. | Pjesemarrje në ndërkrahasime laboratorike apo PT në kuader të projekteve të EURAMET-it, projekteve bilaterale, apo ato të organizuara me nismen e DPM-se në fushat e mases, temperatures, lageshtise. forces, gjatesise, presion etj. | Rezultatet e ndërkrahasimeve apo PT nga organizatoret. | Çdo sektor dhe specialist i DMSHI | Gjate vitit, organizime te EURAMET-it. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | | marredhenie ve dypaleshe, nisme e DPM-se |
| **Objektivi nr.3: Ngritja e nivelit tekniko-profesional të punonjesve të DMSHI** | | | | |
| 3. | Pjesemarrje ne workshope, seminare dhe trajnime te organizuara (sipas mundesive financiare) me mbeshtetjen e buxhetit te shtetit apo organizatoreve te projekteve. | Organizimi i seminareve dhe pjesemarrja ne trainime, pajisja me certifikate | Specialiste te sektoreve sipas fushave te aktivitetit dhe mundesive financiare | Sipas programeve te vecante te |
| 4. | Pjesemarrje ne trajnimet e organizuara nga ASPA | Realizimi i trajnimit | Cdo specialist dhe sektor | Sipas programit te publikuar nga ASPA |
| 5. | Pjesemarrje ne takimet vjetore dhe takimet e Komiteteve Teknike te Organizatave Evropiane dhe Nderkombetare te metrologjise: EURAMET, WELMEC, PTB, BIPM, EMPIR etj | Realizimi i pjesemarrjes ne aktivitet, raporti perkates | Sipas prioriteteve, se pari laboratoret qe kane deklaruar aftesite matese kalibruese apo ato te planifikuar per akreditim | Gjate vitit, sipas planifikimit |
| **Objektivi nr.4: Realizimi në kohë dhe me cilësi i kërkesave të subjekteve të jashtëm dhe të brëndshëm për shërbime kalibrimi.** | | | | |
| 6. | Realizimi i kalibrimit te instrumenteve matës, sipas kerkesave te klienteve ne masen 1800 kalibrime. | Dhenia e certefikatave te kalibrimit. | Sektoret sipas planifikimeve, Specialistet e fushes | Gjate vitit |
| 7. | Realizimi i kalibrimit te instrumenteve mates kampion te Sektoreve te Sherbimeve te DML-se dhe sektorit te produkteve te parapaketuara dhe laboratoreve te DMSHI-se. | Dhenia e certefikatave te kalibrimit | Sektoret/Specialiste te fushes perkatese | Sipas planit, kerkuar nga te interesuarit |
| **Objektivi nr. 5: Ngritja e fushave te reja apo zgjerimi i atyre egzistuese** | | | | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 8. | Zgjerimi i kapaciteteve te laboratoreve ekzistues me pajisje dhe aksesore te nevojshem sipas kerkesave. | Riparim apo blerje e instrumentave | DMSHI | Gjate vitit |
| 9. | Blerje e versioneve me te fundit te standarteve teknike sipas fushave perkatese | Blerja e standarteve nga DPS | DMSHI | Gjate vitit |
| 10. | Rishikim i procedurave te laboratorit te densitetit,pH dhe konduktivitetit | Miratimi i procedurave te kalibrimit. | Sektori i M &D<br>Sektori VRR&K | Gjate vitit |
| 11. | Zhvillimi i fushes se re per kalibrimin e instrumenteve<br>a. termometrave me rrezatim,<br>b. specimeter,elkometer<br>c. mates lartesie (dixhital analog)<br>d. diametrave te brendshem dhe te jashtem | Pregatitja dhe miratimi i procedurave te kalibrimit.<br>Realizimi i kalibrimit te instrumentave te subjekteve | Laboratori i temperatures<br>Sektori i Matjeve Dimensionale | Gjate vitit |
| **Objektivi nr. 6: Mirembajtja e sistemit te menaxhimit te cilesise me DMSHI dhe DPM ne perputhje me SSH EN ISO/IEC 17025:2017.** | | | | |
| 12. | Draftimi/rishikimi dhe miratimi i procedurave te kalibrimit/instruksioneve te punes per laboratoret DMSHI-se ne perputhje me dokumentacionin e Sistemit te Menaxhimit te Cilesise se DPM-se. | Miratimi i te gjithe procedurave dhe instruksioneve te harutara dhe venia ne zbatim e tyre | Te gjithe laboratoret | Gjate vitit |
| 13. | Ndjekja me perparesi e korrigjimit te jo -konformiteteve te konstatuara gjate auditimeve te brendshme te laboratoreve te DMSHI-se si dhe venia ne zbatim e rekomandimeve te dhena nga ekspertet. | Gjate vitit, sipas afateve te percaktuara ne planet e masave korrigjuese<br>Raporti i plotesimit te jokonformiteteve. | Te gjithe laboratoret | Gjate vitit |
| **Objektivi nr. 7: Aplikimi per akreditim apo aftesite matese kalibruese** | | | | |
| 14. | Pergatitja per aplikim per akreditim te laboratoreve te matjeve elektrike, temperatures, lageshtires, kimise, gjatesia nga nje trup akredituese, firmetare e EA-MLA per kalibrim. | Aplikim prane trupave akredituese | Laboratoret respektive ne bashkepunim me DSCP-ne. | Gjate vitit |
| 15. | Realizimi i vizitave vleresuese nga ekspertet e trupes akredituese, firmetare e EA-MLA per kalibrim. | Realizimi i vizites vleresuese | DMSHI | Gjate vitit |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 16. | Realizimi i auditit (peer review) nga eksperte te huaj te EURAMETIT per mirembajtjen e aftesive matese kalibruese (CMC) ne laboratorin e mases, presionit, volumeve. | Realizimi i vizitave vleresuese | Laboratori i mases, volumeve dhe presionit | Gjate vitit |
| **Objektivi nr. 8: Forcimi i bashkepunimit me strukturat nderkombetare dhe europiane te metrologjise, me homologet** | | | | |
| 17. | Pjesmarrje aktive ne aktivitetet e WGCB te EURAMET dhe ne Asamblene e Pergjithshme te EURAMET | Raportimet e realizimit te objektivave | Personat pergjegjes sipas Planit | Sipas planifikimit |
| 18. | Trajtimi i ceshtjeve per nenshkrim apo rishikim te marreveshjeve te bashkepunimit me institutet homologe te rajonit dhe me gjere (Mal i Zi, Maqedoni, Greqi, Kosove) | Nenshkrim i marreveshjeve | DMSHI pjesemarrese ne grupet e punes | Gjate vitit |
| 19. | Pjesemarrje ne takimet e EURAMET, BIPM-se, PTB-se Projekteve te EMPIR. | Pjesemarrje ne takim dhe raporti i rezultateve te pjesemarrjes | DMSHI ne grupet pjesemarrese | Gjate vitit, sipas planifikimit |
| **Objektivi nr. 9: Bashkepunimi me ministrite dhe institucionet e tjera qendrore** | | | | |
| 20. | Bashkepunim me institucionet kerkimore shkencore dhe universitetet, me strukturat e cilesise ne vend | Shkembim informacioni | DMSHI/DPM | Gjate vitit |
| 21. | Bashkepunim me Drejtorine e Pergjithshme te Doganave | Shkembim informacioni me interes te ndersjellte, lidhur me subjekte aktive ne fushen e metrologjise | DMSHI/DPM | Gjate vitit |

DREJTORIA E METROLOGJISË LIGJORE

| NR. | EMËRTIMI I AKTIVITETIT | TREGUES PERFORMANCE TË MATSHËM | STRUKTURA PËRGJEGJËSE | AFATI |
|---|---|---|---|---|
| **Objektivi nr. 1: Mbrojtja e konsumatorëve nga matjet e pasakta** | | | | |
| 1. | Mbrojtja e konsumatorit dhe shtetit nga rezultatet e pasakta të matjeve të instrumenteve matëse, nëpërmjet realizimit të shërbimit të verifikimit të instrumenteve matës ligjërisht të kontrolluar. | Realizimi i **39 100** shërbimeve të verifikimit të instrumenteve matës ligjërisht të kontrolluar dhe mbledhja e të ardhurave në masën e **51 261 000 lek** (pa TVSH).<br>39 100 shërbime verifikimi, të ndara sipas 4-mujorëve:<br>- 12 203<br>- 12 798<br>- 14 099 | 4 (katër) Sektorët e Shërbimeve dhe DML-ja. | - 4-mujori i I,<br>- 4-mujori i II,<br>- 4-mujori i III |
| 2. | Pranimi, administrimi dhe trajtimi i kërkesave të dërguara nga Personat fizik dhe Subjektet juridik, si dhe përcjellja në Sektorin e Shërbimit përkatës, për kryerjen e shërbimit sipas kërkesës. | Trajtimi i kërkesave dhe ndjekja e tyre deri në përfundim të procedurës. | Specialistët e Sektorëve dhe DML-ja | Përgjatë gjithë vitit |
| 3. | Hartimi i projekt planeve dhe miratimi i planeve mujore, 4-mujore dhe vjetor të punës, për çdo punonjës dhe zonë shërbimi, për secilin sektor. | Përgatitja e projekt planeve, referuar realizimit të vitit paraardhës dhe në zbatim të strategjisë së metrologjisë, si dhe miratimi i planeve të punës së sektorëve të Shërbimeve. | Çdo specialist në çdo sektor shërbimi, përgjegjësat e sektorëve të shërbimit, Specialist i DML, Drejtor i DML dhe DP | Nëntor-Dhjetor |
| 4. | Shpërndarja e punës mes specialistëve të sektorit, me qëllim që të sigurohet cilësia dhe realizimi në kohë i shërbimeve metrologjike të kërkuara nga subjektet. | Ndarja e zonave të shërbimit, për çdo punonjës, në secilin sektor shërbimi. | Përgjegjësat e Sektorëve, Drejtor i DML-së | Janar dhe në rast nevoje edhe gjatë vitit |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 5. | Mbajtja e dokumentacionit teknik për dokumentimin e punës së verifikimit të instrumenteve matëse ligjërisht të kontrolluar, në zbatim të legjislacionit në fuqi. | Përgatitja dhe mbajtja e dokumentacionit të punës gjatë shërbimit të verifikimit, të tilla si:<br>-protokoll matje, certifikata verifikimi, si dhe<br>-raportimi i tyre në sektor, përmes databazës, pasqyrave 6 dhe 7. | Çdo specialist, në çdo sektor shërbimi | - Për çdo procedurë verifikimi<br>- në fund të çdo muaji |
| 6. | Raportimi i gjithë dokumentacionit financiar, në kohën e përcaktuar në planin e punës dhe sipas rregullores e urdhërave. | Dërgimi dhe vërtetimi i dokumentacionit financiar për punën e realizuar, përmes: Pasqyrës nr.3, pasqyrës nr.8 dhe librit të shitjes. | Çdo specialist, në çdo sektor shërbimi | Në fund të çdo muaji, si dhe sa herë është e nevojshme, ose kërkohet nga struktura eprore |
| 7. | Kontrolli dhe përgatitja e dokumentacionit përmbledhës të punës mujore të sektorit për treguesit: Instrumente matës, subjekte dhe të ardhura, si dhe dërgimi në DML dhe Sektorin e Financës në DPM. | Kryerja e verifikimit të dokumentacionit të dorëzuar nga punonjësit, si dhe përgatitja e relacioneve përmbledhëse (pasqyrat nr.3, 7, 8, databaze, libër shitjesh dhe progresiv). | Përgjegjësat e sektorëve të DML-së | Në fund të çdo muaji, fillim i muajit pasardhës |
| 8. | Ndjekja e gjithë procedurës së përcaktimit të kapacitetit të rezervuarëve. | Trajtimi i kërkesave, përcjellja në sektorin përkatës, administrim i dosjeve dhe lëshimi i dokumentacionit për subjektin. | Specialist i DML-së, Drejtori i DML-së, Specialist i Sektorëve, Përgjegjësat e Sektorëve dhe DP | Në vazhdimësi, sipas kërkesave të Subjekteve |
| 9. | Trajtimi i ankesave të Subjekteve. | Administrimi dhe kthim përgjigje në kohë të ankesave të adresuara. | DML, DPM | Në vazhdimësi, sipas rastit |
| **Objektivi nr. 2: Kryerja e Shërbimeve Metrologjike përmes autorizimeve, kur DPM nuk ka kapacitetet teknike për t'i realizuar vetë** | | | | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 10. | Autorizimi i subjekteve private për kryerjen e veprimtarive në Metrologjinë Ligjore. | Trajtimi i kërkesave për autorizim, të subjekteve juridikë dhe fizikë, shqyrtim i dokumentacionit përkatës, kryerja e vizitave vlerësuese dhe nxjerrja e vendimeve administrative për dhënie autorizimi, për verifikim ose riparim dhe verifikim të instrumenteve matëse ligjërisht të kontrolluara, kur DPM-ja nuk ka kapacitetet teknike për t'i realizuar vet këto detyra. | DML, DMSHI, DBNJ&SH, DSCP | Sipas kërkesave të subjekteve, përgjatë vitit |
| 11. | Trajtimi i dokumentacionit të raportuar nga subjektet e autorizuara për verifikim të instrumenteve matëse ligjërisht të kontrolluara, si: matës të energjisë elektrike, matës të ujit, autobote, si dhe atyre për riparim instrumentesh matëse, si: peshore të kapacitetit të madh dhe shpërndarës karburanti, si dhe mbajtja e grafikut për to. | Administrimi i raportim aktiviteteve të Subjekteve të autorizuara nga DPM-ja. | Specialist i DML | Sipas afateve 3-mujor të raportim aktiviteteve për çdo subjekt të autorizuar |
| 12. | Planifikim i kryerjes së vizitave monitoruese. | Përgatitja e planit për kryerjen e vizitave monitoruese, në subjektet e autorizuara nga DPM-ja, për vitin 2023. | DML | Janar |
| 13. | Kryerja e vizitave monitoruese 1-vjeçare në Subjektet e autorizuara nga DPM-ja. | Kryerja e 16 vizitave monitoruese, sipas planit të miratuar për kryerjen e vizitave monitoruese përgjatë vitit 2023 dhe ndjekja e procedurave përkatëse, deri në lëshimin e raportit të vizitës monitoruese për subjektin. | Grupi i punës i ngritur me urdhër të DP, me përfaqësues nga: DML, DMSHI, DBNJ&SH, DSCP | Janar, Mars, Prill, Maj, Qershor, Shtator, Tetor, Nëntor |
| **Objektivi nr. 3: Miratimi i akteve nënligjore në zbatim të ligjit Nr.126/2020 datë 15.10.2020 "Për Metrologjinë"** | | | | |
| 14. | Miratimi i urdhërave të brendshëm të Drejtorit të Përgjithshëm në përputhje me aktet nënligjore të miratuara. | Urdhër "Për përcaktimin e tipit, formës dhe fiksimin e shenjave të përdorura për verifikimin e instrumentave matës ligjërisht | DML, DSCP | 3-mujori i I |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | të kontrolluara, si dhe formën dhe përmbajtjen e certifikatës së verifikimit". | | |
| **Objektivi nr. 4: Rishikimi dhe miratim i urdhërave të brendshëm dhe procedurave të verifikimit** | | | | |
| 15. | Rishikimi dhe miratimi i urdhërave të brendshëm për pjesën e Metrologjisë ligjore | Urdhëri i DP të DPM-së nr.279, datë 16.10.2017 "Për rregjistrimin, dhënien e vërtetimit dhe certifikatës së matjes së vëllimit të depove/rezervuarëve të naftës bruto, gazit dhe nënprodukteve të tyre".<br>Rishikim dhe miratim i procedurave të verifikimit të instrumenteve matës të gjatësisë, volumeve dhe kaspaciteteve të shërbimit, taksimetrave. | DML<br><br>DML, DMSHI | 3-mujori i I |
| **Objektivi nr. 5: Aplikimi për Akreditim në fushën e masës** | | | | |
| 16. | Hartimi dhe Implementimi i kërkesave të standartit ISO IEC 17020:2012 në laboratorët e masës të Sektorit të Shërbimit nr. 2, Fier, 3, Lezhë dhe 4, Korçë. | Miratimi i procedurës së verifikimit të instrumenteve të peshimit.<br>Hartimi dhe miratimi i procedurave teknike dhe formave përkatëse, për implementimin e kërkesave të standartiti ISO IEC 17020:2012. | DML, Sektori i Sigurimit të Cilësisë në DSCP dhe Sektorët e Shërbimit 2, 3 dhe 4 të DML-së | Shkurt<br><br>3-mujori i I |
| 17. | Organizimi dhe koordinimi i aktiviteteve në lidhje me procesin e akreditimit të laboratoreve/fushave të aktivitetit të planifikuara nga DPM/DML për vitin 2023. | Përgatitja e dosjes për aplikim dhe dorëzimi pranë trupës akredituese, që do të përzgjidhet nga DPM. | | 6-mujori i I |
| 18. | Aplikim për akreditim në fushën e masës. | Aplikimi pranë trupave akredituese, përmes plotësimit të formularit të aplikimit. | | |
| **Objektivi nr. 6: Mirëmbajtja e instrumenteve që përdoren për verifikim** | | | | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 19. | Kalibrimi i etaloneve sekondarë që përdoren për verifikimin e instrumenteve matës (enë qelqi dhe metalike), në fushën e volumeve, në Sektorët e Shërbimit të DML-së. | Kalibrimi i instrumenteve të volumeve. | DML, Sektori i Volumeve, Rrjedhjeve dhe Kimisë i DMSHI-së, Sektorët e Shërbimeve të DML-së | Qershor, Korrik |
| 20. | Kalibrimi i instrumenteve matës në fushën e masës (peshore dhe gramarë), në Sektorët e Shërbimit të DML-së. | Kalibrimi i instrumenteve të peshimit. | DML, Sektori i Masës dhe Densitetit i DMSHI-së, Sektorët e Shërbimeve të DML-së | Janar, 6-mujori i II |
| **Objektivi nr. 7: Forcimi i bashkëpunimit me strukturat ndërkombëtare të metrologjisë** | | | | |
| 21. | Pjesëmarrje aktive në aktivitetet e organizuara nga WELMEC. | Raportimet e realizimit të objektivave, në përfundim të aktivitetit. | Personat përgjegjës nga DML (Drejtor i DML-së) | Sipas kalendarit të aktiviteteve të këtyre organizatave ndërkombëtare |
| 22. | Pjesëmarrje në takimet, konferencat dhe webinaret e organiztave ndërkombëtare, ku DML është pjesë, si: OIML, WELMEC. | Pjesëmarrje në takim dhe raporti i rezultateve të pjesëmarrjes. | Drejtor i DML-së | |
| **Objektivi nr. 8: Bashkëpunime ndërinstitucionale** | | | | |
| 23. | Bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë (MFE) dhe Agjencinë Kombëtare të Ujësjellës Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve (AKUM), për zgjidhjen e situatës së verifikimit të matësave të ujit. | Takime, komunikime zyrtare, marrëveshje bashkëpunimi | DML, DPM | Përgjatë vitit |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 24. | Bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, për Subjektet aktive, objekt i fushës së ligjit nr.126/2020 "Për metrologjisë". | | | |
| 25. | Bashkëpunim më Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, për importet e kryera të instrumenteve matëse ligjërisht të kontrolluar. | Shkëmbim informacioni me interes të ndërsjelltë, lidhur me fushën e metrologjisë | | |
| 26. | Bashkëpunim me Inspektoratin Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut (ISHMT), për problematikat e terrenit, mbi subjektet që nuk pranojnë dhe/ose pengojnë verifikimin e instrumenteve matëse ligjërisht të kontrolluar. | | | |
| 27. | Bashkëpunim me Agjensinë e Administrimit të Tregjeve, për numrin e Subjekteve që ushtrojnë aktivitet në tregjet e Bashkive Tiranë, Durrës dhe Elbasan. | | | |
| **Objektivi nr. 9: Zhvillimi i nivelit tekniko-profesional të punonjësve të DML** | | | | |
| 28. | Ndjekja e një cikli trajnimesh për punonjësit e rinj dhe ata me eksperiencë. | Pjesëmarrje në trajnim | Specialistët e Sektorëve të DML-së | 6-mujori i parë i punës së punonjësve të rinj |
| 29. | Përgatitja e një plani trajnimesh për vitin 2023, në fushën e masës, volumeve dhe parapaketimeve. | Hartimi i planit, miratimi dhe zbatimi i tij | DML, Sektorët e Shërbimeve | Janar |
| 30. | Pjesëmarrje në trajnime dhe webinare të organizuara nga ASPA, ose institucione të tjera. | Realizimi i pjesëmarrjes në trajnim/webinar | DML, Specialistët e Sektorëve të Shërbimit | Sipas programit të publikuar nga ASPA |
| **Objektivi nr. 10: Fushata informuese** | | | | |

Adresa: Autostrada Tiranë-Durrës, km 8, Kashar, Tiranë, web: www.dpm.gov.al, e-mail: metrology@dpm.gov.al

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 31. | Informimi i konsumatorëve për rëndësinë e verifikimit të instrumentave matës ligjërisht të kontrolluar. | Fushatë informimi dhe ndërgjegjësimi | DML, Sektorët e Shërbimeve, DPM | Maj |
| 32. | Informimi i përdoruesve të instrumenteve matës ligjërisht të kontrolluar për detyrimet dhe përgjegjësit e tyre. | Informim dhe diskutime | DML, Sektorët e Shërbimeve, DPM | 4-mujori i III |
| 33. | Publikimi i materialeve informuese dhe promovuese në faqjen zyrtare të DPM-së. | Përgatitja e materialeve dhe publikimi i tyre | DML | 4-mujori i I dhe në vazhdimësi |

**DREJTORIA E SIGURIMIT TE CILESISE DHE PARAPAKETIMEVE**

| NR. | EMËRTIMI I AKTIVITETIT | INDIKATORËT | STRUKTURA PËRGJEGJËSE | AFATI |
|---|---|---|---|---|
| **Objektivi nr.1: Mirembajtja e Sistemit te Menaxhimit te Cilesise sipas ISO 17025 dhe CIPM MRA, zgjerimi i SMC ne laboratore/fusha te tjera, ne perputhje me prioritetet/planin e Drejtorise se Metrologjise Shkencore dhe Industriale per vitin 2023** | | | | |
| 1. | Rishikimi i dokumentacionit të Sistemit të Menaxhimit te Cilësisë sipas standardit ISO/IEC 17025:2017 dhe (CIPM MRA) me qellim integrimin dhe te kerkesave te ISO/IEC 17043, si dhe bazuar ne nevojat e evidentuara gjate vitit 2022. | Miratimi i Dokumentacionit te rishikuar nga Drejtori i Përgjithshëm/Menaxheri teknik (sipas rastit) dhe vënia në dispozicion të strukturave përkatëse dhe në Intranet-in e DPM | Erinda Piluri Menaxheri i Cilësisë<br>Personat pergj. sipas fushes se aktivitetit dhe autorizimeve perkatese | Gjate gjithe vitit |
| 2. | Hartimi i procedurave operacionale dhe protokolleve teknike per organizim te ILC-ve per fushat e perzgjedhura per organizim te testeve te zotesise/nderkrahasimeve nder-laboratorike per 2 fusha matjeje sipas prioriteteve te DMSHI. | Dokumentacioni i rishikuar (Manuali i Cilesise dhe procedurat operacionale) miratohet nga strukturat eprore dhe vihet ne zbatim.<br>Hartimi i protokolleve teknike per 2 fusha matjeje sipas prioriteteve te DMSHI | Erinda Piluri Sektori i Sigurimit te Cilesise<br>Sektoret teknike te DMSHI | 6-mujori pare 2023 |
| 3. | Zgjerimi i Sistemit te menaxhimit sipas ISO /IEC 17025 ne laboratoret e DMSHI, sipas prioriteteve te percaktura nga kjo drejtori dhe Drejtori i Pergjithshem. | Hartimi dhe rishikimi i dokumentacionit te SMC te laboratoreve, organizimi i auditimeve te brendeshme, evidentimi i | Sektori i Sigurimit te Cilesise | Gjate gjithe vitit |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
